



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 27/2015

Prishtinë, më 21.7.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Enver Hoti - anëtarë.

Munguan: Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardita Zejnullahu-AMPEK; Kaltrina Ahmeti - GLPS; Visar Berisha dhe Dardan Abazi - INDEP; Lejla Selimi - OSBE; Naile Selimaj dhe Liridon Dalipi – KPM; Lumniye Murati – ZPRK; Remzije Hajdari – MTI; Besa Berisha (praktikante UNDP).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14 dhe 16.7.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 029 për Patenta;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 026 për Markat tregtare;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14 dhe 16.7.2015

Procesverbalet e mbledhjeve të datës 14 dhe 16.7.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore

Kryetari Muhamet Mustafa, tha se kemi rekomandime nga Komisioni për Integritet Evropian lidhur me amendamentin nr.10 dhe do të përqendrohemi aty, ndërsa te amendamentet tjera, do të shikojmë natyrën e vërejtjeve të tyre dhe do t'i analizojmë. Sa i përket vërejtjeve të amendamentit nr. 10, mendoj se duhet ta analizojmë duke u nisur nga tri kritere: e para është që ne të sigurojmë një plotësim sa më të mirë të nevojave për informim të opinionit; e dyta që të ruajmë konkurrencën fer; dhe e treta, që gjithashtu të jemi të kujdesshëm për të mbrojtur industrinë vendore në fushën e mediave, potencoi z.Mustafa. Lidhur me këtë, ai shprehu mendimin se duhet gjetur një formulim që nuk i përjashton operatorët e shërbimeve të mediave, por nuk i lejon që të krijojnë monopol me menaxhimin e multipleksit, kjo do të ishte optimale. Më tutje, z.Mustafa theksoi se ekziston një direktivë evropiane, nr. 2002/77, e cila sugjeron zgjedhje të ndryshe nga ajo që ka propozuar Komisioni. Kryetari Mustafa shprehu mendimin se duhet të shikojmë ose kah heqja e këtij amendamenti ose kah modifikimi i tij dhe e konsideroi si hap më të mirë modifikimin e tij, sesa heqjen. Z. Mustafa propozoi riformulimin e amendamentit 10 si vijon:

Amendamenti 10

Neni 7, pas paragrafit 3, shtohet edhe një paragraf i ri si vijon:

Në rast se ofruesi i shërbimeve mediale është në të njëjtën kohë edhe operator i multipleksit, KPM-ja do të përcaktojë rregulla për mbajtjen e llogarive të ndara, për evitimin e monopolit dhe sigurimin e konkurrencës fer në tregun medial.

Raif Qela, tha se gjatë të gjitha fazave të punimit lidhur me këtë projektligj, grupi punues e ka pasur të qartë se ka mundësi që nëse nuk rregullohet mirë me këtë ligj, digjitalizimi mund të shkojë në një proces i cili do të nxjerrë operatorë të multipleksit, të cilët do të jenë zot të mediave, pra krijohet mundësia që të monopolizohet fusha e mediave. Kjo, shtoi ai, më së shumti ka mundësi të bëhet në dy raste, po që-qe se ofruesi i shërbimeve mediale është njëkohësisht edhe operator i multipleksit dhe nëse ndonjë provajder i këtyre shërbimeve në mediumet tjera që ka ndikim të theksuar në këtë treg, p.sh. në rrjetet kablore, siç e përmendi profesori (është fjala për deputetin M.Mustafa) operatori i rrjetit është bërë në të njëjtën kohë edhe operator i multipleksit. Më tutje, z.Qela potencoi se një udhëzues që ka nxjerrë ITU-ja, në faqet 175-176, janë paraqitur skema të cilat tregojnë të gjitha mundësitë e raportit ndërmjet operatorit të multipleksit, ofruesit të shërbimeve mediale dhe operatorit të rrjetit dhe në asnjërin prej tyre nuk parashihet që operatori i multipleksit mund të jetë dhe ofrues i shërbimeve mediale. Ai potencoi se pse duhet t'i lejohej një ofruesi të shërbimeve mediale, d.m.th. një televizioni që të bëhet zot i mediave edhe t'i diskriminojë në këtë mënyrë rivalët e vet. Kjo është tepër e rrezikshme, sepse do ta ngulfasë ashtu siç është, duke ngulfatur deri më sot fushën e mediave. Nëse lejohet që kjo fushë të monopolizohet, prej cilitdo nga ofruesit e shërbimeve të mediave, atëherë kemi bërë si mos më keq këtë punë, theksoi z.Qela. Në vazhdim, ai tha se, nëse ne ofruesve të shërbimeve mediale lokale iu ofrojmë ashtu siç i ka propozuar KPM-ja, që ofruesit e shërbimeve të mediave lokale të mblihen në konzorciume dhe në përputhje me të, të bëjnë multipleksët rajonalë dhe kështu të gjithë do të rehatohen, sepse edhe nuk ka rrezik prej tyre që të monopolizojnë tregun. Ndërsa, ofruesit e shërbimeve mediale që përfshijnë tërë territorin, të mos jenë njëkohësisht edhe operatorë të multipleksit, sepse bëhen monopolizues të kësaj fushe.

Formatted: Not Highlight

Më pas, z. Qela propozoi si vijon:

Amendamenti 10

Neni 7.4: 1. Përveç transmetuesit publik të Republikës së Kosovës, asnjë ofrues tjetër i shërbimeve mediale nuk mund të jetë operator i ndonjërit prej tre multipleksëve për transmetim në tërë territorin e Kosovës, e të cilët do të jepen me koncesion në fazën kaluese nga transmetimi analog në atë digjital tokësor.

Kjo, shtoi ai, është veç faza kalimtare ku jepen 3 multipleksë, mundësia është që në të ardhmen të jepen edhe ndryshe, qoftë t'u jepet kompetenca [KPM-së](#), që të vazhdojë me “beauty contest” apo me mënyra tjera.

Besim Beqaj, tha se ne jemi të gjithë këtu për ta evituar monopolin. Unë i kam shikuar me kujdes edhe praktikatat evropiane, edhe direktivat evropiane dhe kam marrë informacion rreth gjërave që ndodhën në rajon në procesin e digjitalizimit. Ai shprehu mendimin se amendamenti 10, sipas përbërjes që kemi pasur, duhet të ndryshohet, sepse është rrezik për monopol. Z.Beqaj theksoi se ka shikuar edhe direktivën e Bashkimit Evropian nr. 2002/77, neni 2, pika 1, që thotë se shtetet anëtare nuk do të japin të drejtë ekskluzive apo speciale për ndërtimin, shfrytëzimin e rrjeteve për komunikime elektronike, që përdoret për shërbime të telekomunikimeve elektronike që janë për qasje publike. Pika 2 thotë se shtetet anëtare do të ndërmarrin të gjitha të drejtat, masat e nevojshme për të siguruar se cila do ndërmarrje ka të drejtë të ofrojë shërbime të komunikimeve elektronike apo të ndërtojë e të zgjerojë apo të ofrojë mjete për komunikime elektronike. Pika 3, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që nuk do të vendoset ose të mbajnë kurrfarë ndalesash që shërbimet e komunikimeve elektronike të kryhen përmes rrjeteve elektronike të ndara nga operatorët e komunikimeve elektronike nga pala e tretë apo përmes qasjes së përbashkët të rrjeteve apo pikave, pa paragjykuar direktivat 2002/1, 2002/20, 2002/21 dhe 2002/22. Prandaj, lidhur me amendamentin, z.Beqaj shprehu mendimin se duhet riformuluar, për ta riformuluar në kuptimin e asaj që një përgjegjësi të drejtpërdrejt do t'ia lëmë edhe KPM-së, sa i përket rregullimit të atyre gjërave dhe eliminimit të rrezikut për monopol. Deputeti Beqaj pohoi se duhet të shkojmë në atë rrugë, që mos të krijojmë monopole.

Visar Ymeri, tha se unë jam dakord me atë që u tha, sa i përket amendamentit 10, veçanërisht propozimin që e ka sjellë KPM-ja në formën e vet, më duket që kjo e mbulon apo formalisht lejon mundësi që të mos monopolizohet tregu, sepse mos të them se natyrisht se ne përgjigjemi për këtë pjesën formale, domethënë krijimit të hapësirës ligjore, ku të gjithë të jenë të barabartë në konkurrencën e tyre në treg.

Muhamet Mustafa, ne mund të bëjmë vetëm ndonjë redaktim, por jo edhe të shtojmë paragraf të ri, sepse jemi në fazën që duhet të dërgohet raporti në lexim të dytë, përndryshe nëse bëjmë ndryshime, duhet ta riprocetojmë përsëri tek komisionet e përhershme. Tek amendamenti 10, nuk mund të jetë operatori prej 3 multipleksëve tash i ke cek edhe 3 multipleksët, të cilët do të jepen në koncesion në fazën kaluese, ndërsa kjo që po cek tani, që të jetë në frymën e kësaj direktive, siç e citoi deputeti Beqaj dhe shtoi se mund të ketë riformulim, ku KPM-ja do t'i përcaktojë rregullat për mbajtjen e llogarive të ndara për evitimin e monopolit dhe sigurimin e konkurrencës fer në tregun medial, dhe mund të shtojmë, në frymën e direktivës.

Besim Beqaj, tha se zgjidhja me propozimin e kryetarit është në frymën e Direktivës Evropiane nr. 2002/77.

Propozimi i kryetarit, me plotësimin e z.Beqaj, me 7 (shtatë) vota për, 1 (një) kundër, u përkrah nga Komisioni.

Raif Qela, propozoi edhe disa ndryshime, ku disa prej tyre janë vetëm sipërfaqësore, nuk prekin në thelbin e problemit, vetëm e precizojnë më mirë nenin, janë formulime më të sakta, prandaj t'i shohim nenet veç e veç, sepse nuk është e nevojshme të shkojnë në komisione të përhershme nëse nuk ka diçka përmbajtjesore. P.sh. vazhdoi ai, në amendamentin 6 që e kam propozua është vetëm vazhdim i kuptimit të shprehjes “must carry” përmban bartje të detyrueshme, pra nuk mjafton vetëm ky shpjegim, mirëpo t'i shtohet teksti: “në multipleks të kanaleve televizive të licencuara për transmetim analog tokësor”. Pastaj zoti Qela tha se amendamenti 17, duhet të riformulohet dhe t'i shtohet një paragraf ku krejt ofruesit rajonalë dhe lokalë rregullohen dhe kjo besoj se e zgjidh pjesën më të madhe të problemit të këtij neni. Te pjesa tjetër, jam shumë i bindur se çfarëdo forme e formulimit tjetër do të lejojë mundësinë për monopol. [Prandaj, ai propozoi një formulim alternativ, në vend të amendamentit 10, i cili, sipas tij, do ta rregullojë çështjen e rrezikut nga monopoli:](#)

[Para inicimit të procedurës së garës publike për dhënie në shfrytëzim të frekuencave për transmetime digjitale, KPM, në bashkëpunim me Autoritetin do të bëjë analizën Ex-Ante për tregun e transmetimeve radiodifuzive tokësore dhe të tregjeve relevante, të ndërmarrë masa dhe të vendosë kufizime eventuale me qëllim të ruajtjes së konkurrencës në treg, sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Komunikime Elektronike, duke u mbështetur në Direktivën Europiane 2002/77/EC.](#)

Besim Beqaj, tha se nëse kthehemi për të hapur secilin nen, realisht secili prej nesh e ka një mendim ndryshe. Për këtë arsye, janë grupet punuese, sponsoruesit e ligjeve, e keni parasysh se nëse ne devijojmë ligjin nga ajo që ka menduar sponsoruesi, ai mund ta tërheqë ligjin prej Kuvendit. Ai shtoi se ne duhet ta dimë që nuk e kemi fuqinë e tillë që ta bëjmë ligjin vetë, sepse nëse sponsori vlerëson se ligji nuk është në harmoni me atë që e ka dhënë dhe se ka çfarëdo konflikti me ligjet e tjera, ai tërhiqet nga Kuvendi dhe na kthen prapë procedurën prej fillimit.

Kryetari, tha se sa i përket rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropiane, tek amendamentet 26 dhe 27, Komisioni mbetet pranë qëndrimit të tij, sepse konsideron që janë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 141, ku përcaktohen qartë kompetencat e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Komisioni, me 7(shtatë) vota për,1(një) kundër, asnjë abstenim, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr.05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

2. Raporti t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë, sipas procedurës së rregullt.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 029 për Patenta

Kryetari Muhamet Mustafa, njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues ka shqyrtuar projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 029 për Patenta. Po ashtu, janë hartuar disa amendamente, të cilat më tepër janë të karakterit teknik, dhe sot në këtë mbledhje, e paraqesim raportin me amendamente.

Amendamenti 1

Lidhur me amendamentin 1, kryetari Muhamet Mustafa, tha se në projektligj thuhet që: “Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën”, por kjo konsiderohet se ligji është në tërësi në përputhje me direktivat, derisa në opinionin e Ministrisë së Integritetit Evropian thuhet që ligji është pjesërisht i përfruar me direktivat. Bazuar në këtë, kryetari Mustafa propozoi tekstin: “Qëllimi i projektligjit është harmonizimi me direktivat si më poshtë:”.

Besim Beqaj, tha se fjala përputhshmëri dhe harmonizim nënkupton harmonizim apo përputhshmëri të plotë me direktivat dhe propozoi që të përdoret fjala “përaftrim”.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që amendamenti 1, të fshihet dhe për këtë çështje të vendosë Komisioni për Integritet Evropian.

Amendamentet tjera, prej 2 deri në 11, u përkrashën nga Komisioni.

Pas miratimit të amendamenteve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 029 për Patenta.

2. Raporti me amendamente t'u procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 026 për Markat tregtare

Kryetari Muhamet Mustafa, njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 026 për Markat tregtare, janë hartuar disa amendamente të cilat më tepër janë të karakterit kryesisht teknik, për- veç dy amendamenteve, të cilat i ka propozuar shoqëria civile, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe GAP-i, për të cilat është pajtuar edhe ministria.

Amendamenti 1

Lidhur me amendamentin 1, tha se është i ngjashëm me amendamentin 1 në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për patenta, andaj edhe në këtë rast të veprojmë njëjtë, pra të fshihet amendamenti 1 dhe këtë çështje mbetet që ta trajtojë Komisioni për Integritet Evropian.

Komisioni e përkrashu propozimin e kryetarit Mustafa.

Amendamentet tjera, prej 2 deri në 12, u përkrashën nga Komisioni.

Pas miratimit të amendamenteve, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr .05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 026 për Markat tregtare.

2. Raporti me amendamente t'u procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

6. Të ndryshme

Kryetari Muhamet Mustafa, tha se anëtarët e Komisionit, ditë më parë, kanë pasur një takim me përfaqësues të industrisë së qumshetit lidhur me problemet që po përballen këta të fundit. Lidhur me këtë, kryetari Mustafa tha se duhet të angazhohemi që të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme për këtë sektor. Ai tha INDEP, që mbështet Komisionin, është duke bërë një hulumtim lidhur me këtë problematikë. Propozoi që të angazhohet nga Komisioni një ekspert, i cili do të bënë një analizë krahasimore me vendet e rajonit, sa i përket sektorit të tregut të qumështit. Si ekspert, z.Mustafa propozoi z. Mentor Thaçi, i cili është profesor në Fakultetin e Bujqësisë.

Visar Ymeri, tha se analiza krahasimtare mos të kufizohet vetëm me vendet e rajonit, por të përfshijë edhe vende tjera evropiane. Z.Ymeri kërkoi që CV-ja e këtij eksperti, të ofrohet në dispozicion të anëtarëve të Komisionit.

Besim Beqaj, tha se është me rëndësi që të analizohen edhe raportet prodhues – përpunues, duke potencuar se kërkesa e sektorit të qumshetit është mbrojtja e tregut nga importi.

Kryetari tha se detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit do të jenë:

1. Analiza e pozitës së industrisë së qumështit në Kosovë dhe një krahasim me pozitën e kësaj industrie në vendet fqinjë, në aspektin e tatimeve dhe taksave, regjimit tregtar (importit,eksportit), subvencioneve, si dhe raporti midis përpunuesve dhe prodhuesve të qumështit.
2. Analiza duhet të adresojë edhe kërkesat e bëra nga shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, drejtuar Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe praktikatat e BE-së, në adresimin e këtyre çështjeve.

Komisioni u pajtua me propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa